

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“ABYSS” sh.p.k

Tiranë më datë 26 / 10 /2022

NENI 1

Shoqëria Tregtare “ABYSS” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

NENI 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “ABYSS” sh.p.k

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e veprimtarisë në dhënien e konsulencës mediatike brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Konkretisht:

1. Shërbime televizive dhe konsulence në fushën e medias;
2. Konsulencë dhe asistencë në fushën e medias;
3. Konsulence fushtash brenda dhe jashtë vendit;
4. Lobing ndërkombëtar; vënie në dispozicion të kontakteve institucionale dhe private vendase dhe të huaja për akses në informacion, akses në rrjete të financës së lartë ndërkombëtare dhe akses në dhomat e arbitrazhit.
5. Vënie në dispozicion të kontakteve dhe lidhjeve institucionale me rrjete investigative ndërkombëtare, me kompani ndërkombëtare të investigimit dhe hetimit me metoda speciale, vënie në dispozicion e kontakteve dhe lidhjeve me industrialistë vendas dhe të huaj.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga e Barrikadave; Qendra Turdiu; K2; N17, Tiranë, Shqipëri.**

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën **1000 (një mijë) lekë.**

Kapitali ndahet në 1 (një) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortaku i shoqërisë vijon si më poshtë:

z. Habjon HASANI, i datëlindjes 17.03.1984, lindur në Fier, identifikuar nëpërmjet ID nr. I40317086D personal, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100 % të kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë 1000 (një mijë) Lekë.

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është nënshkruar nga Ortaku Themelues.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është **z. Habjon HASANI**, lindur më 17.03.1984 në Fier, Shqipëri, shtetas Shqiptar, identifikuar nëpërmjet ID me nr. I40317086D personal, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10



Organizimi dhe funksionimi i shoqrisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit për atës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU

Habjon **HASANI**

Habjon Hasani

2022

